



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI**

**LIGJ**

**Nr. 92/2020**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 16/2018  
“PËR DIASPORËN”**

Në mbështetje të nenit 81, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 68 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, me propozimin e një deputeti,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

Në ligjin nr. 16/2018 “Për diasporën” bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

**Neni 1**

Në nenin 3 pas pikës 5 shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:  
“6. Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët”.  
Pika 6 e këtij neni bëhet pika 7.  
Pika 7 e këtij neni bëhet pika 8.  
Pika 8 e këtij neni bëhet pika 9.  
Pika 9 e këtij neni bëhet pika 10.

**Neni 2**

Pas nenit 4 shtohet neni 4/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 4/1

**Komiteti Shtetëror për Diasporën**

Komiteti Shtetëror për Diasporën është organ konsultativ i Këshillit të Ministrave për bashkërendimin e politikave dhe veprimtarive shtetërore në fushën e diasporës. Ai drejtohet nga Kryeministri. Krijimi, organizimi, mënyra e funksionimit të Komitetit Shtetëror për Diasporën miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.



### Neni 3

Në nenin 5 bëhen këto ndryshime:

Shkronja “ë” ndryshohet me këtë përmbajtje:

“ë) propozon dhënien e bursave studentëve nga komunitetet shqiptare të diasporës për të studiuar në universitetet e Republikës së Shqipërisë. Ato miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.Shkronja “ë” e këtij neni bëhet shkronja “f”.

### Neni 4

Në nenin 9 shkronja “d” ndryshohet me këtë përmbajtje:

“d) dhënies së çmimeve kombëtare dhe medaljeve për kontribut të veçantë në ruajtjen, forcimin e lidhjeve ndërmjet vendit të origjinës dhe diasporës, promovimin e Shqipërisë në botë dhe përkrahjen e interesave të saj. Ato miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”

### Neni 5

Pas nenit 23 shtohet neni 23/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 23/1

### **Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët**

Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët realizon studime të specializuara për historinë, letërsinë dhe kulturën e komunitetit arbëresh. Krijimi, organizimi, mënyra e funksionimit të Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

### Neni 6

### **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**K R Y E T A R I**

**Gramoz RUÇI**

Miratuar në datën 16.7.2020